



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 16 Prot.

Tiranë, më datë 15.01.2024

**VENDIM**  
**Nr. 14, datë 15.01.2024**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 15.01.2024:

**VENDOSI:**

- Shtyrjen e vendimmarrjes së Projektit “Objekt shërbimi 2 dhe 3 kate + 1 kat podrum”, Bashkia Shkodër dhe Raporti i Ndikimit në Pasurinë Kulturore “Hamami” në Shkodër, përgatitur nga individ i licencuar në restaurim znj. Endrita Mulleti, me aplikues Gert Lika dhe **zhvillues Adriatik Suma**, me argumentet vijuese:
  - Të rishikohet projekti sipas rekomandimeve të lëna nga inxhinieri konstruktor me shkresë me nr. 6068 Prot., datë 24.11.2023 të Ministrisë së Kulturës, për sa i përket katit podrum;
  - Të rishikohet distanca e objektit të propozuar nga Pasuria Kulturore “Hamami”, në Shkodër, në mënyrë që most të çënohet Monumenti i Kulturës Kategoria e I-rë.
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
- Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
- Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
**Klesta QIRICI**

